



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.121

25 gusht

2011

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.506, datë 13.7.2011	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Antigone të qarkut të Gjirokastrës.....	4779
Vendim i KM nr.507, datë 13.7.2011	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Sult të qarkut të Elbasanit.....	4780
Vendim i KM nr.508, datë 6.7.2011	Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, në kuadrin e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Europian.....	4781
Vendim i KM nr.509, datë 6.7.2011	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Qendër Fier të qarkut të Fierit.....	4788
Vendim i KM nr.510, datë 6.7.2011	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Peqin të qarkut të Elbasanit.....	4789
Vendim i KM nr.511, datë 6.7.2011	Për adoptimin e eurokodeve të ndërtimit.....	4790
Vendim i KM nr.513, datë 6.7.2011	Për miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe bashkimit të shoqërive “Caraglio” srl & “Hertis” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentraleve në rrjedhën e lumit Shkumbin.....	4790

Vendim i KM nr.518, datë 6.7.2011	Për përcaktimin e kriterëve të dokumentacionit dhe të procedurave për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen e anulimin e lejes së punës të tipit C/PSH.....	4791
Vendim i KM nr.521, datë 20.7.2011	Për një ndryshim në vendimin nr.147, datë 2.3.2011 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve buxhetore të programit buxhetor afatmesëm, 2012-2014”.....	4799
Vendim i KM nr.523, datë 20.7.2011	Për kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e pajisjeve fiskale e të taksimetrave, për 7 bashki dhe 9 komuna.....	4801
Vendim i KM nr.525, datë 20.7.2011	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien e statusit të zhvilluesit të zonës ekonomike në Rrashull, Durrës, dhe miratimin e bonusit për shoqërinë.....	4802
Vendim i KM nr.526, datë 20.7.2011	Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, bursat e shtetit dhe pagesat e nxënësve e të studentëve, në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2011-2012.....	4802
Vendim i KM nr.532, datë 13.7.2011	Për miratimin e kontratës së koncesionit “Për menaxhimin, operimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin teknik të terminalit të konteinerëve në Portin e Durrësit”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Durrës Kurum Shipping” sh.a. dhe “Global Ports Holding” sh.a.....	4808
Vendim i KM nr.563, datë 3.8.2011	Për një shtesë në vendimin nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar	4808
Vendim i KM nr.583, datë 10.8.2011	Për kalimin e pasurisë së paluajtshme Kantieri Detar Durrës dhe Akuatorium në përgjegjësi administrimi të autoritetit Portual Durrës	4810

VENDIM
Nr.506, datë 13.7.2011

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
KOMUNËS ANTIGONE TË QARKUT TË GJIROKASTRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Antigone të qarkut të Gjirokastrës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 47 (dyzet e shtatë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 259 (dyqind e pesëdhjetë e nëntë).

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Antigone për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Antigone

Lidhja nr.1

Numri rendor i pronës në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
20-27, 252	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
28-30	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore	Në pronësi
31-33	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
34	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
35, 36, 38	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
37	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
39	Infrastrukturë (sheshe, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
40-43	Varrezat publike	Në pronësi
45-55	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive). Sip. 24.9 ha i është dorëzuar AKKP-së.	Në përdorim
56-60, 64, 72, 75	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive)	Në pronësi
80-220	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
221-226, 253-259	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

VENDIM
Nr.507, datë 13.7.2011

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS SULT TË QARKUT TË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Sult të qarkut të Elbasanit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 75 (shtatëdhjetë e pesë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 490 (katërqind e nëntëdhjetë).

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Sult për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Sult

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
2-9	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
10	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore	Në pronësi
11-13	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
14-45	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
46-57	Varrezat publike	Në pronësi
58-89	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
351, 353, 355, 356, 359, 361, 362	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
352, 354, 357, 358, 360	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
378-394, 396-441	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
443	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

VENDIM
Nr.508, datë 6.7.2011

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË, NË KUADRIN E PROCESIT TË ANËTARËSIMIT NË BASHKIMIN
EUROPIAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, në kuadrin e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Europian.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË NË KUADËR TË PROCESIT TË ANËTARËSIMIT
NË BASHKIMIN EUROPIAN

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë (këtej e tutje “palët kontraktuese”):

duke u nisur nga objektivi strategjik për të arritur anëtarësimin me status të plotë në Bashkimin Europian;

të vetëdijshëm mbi rëndësinë e reformave politike, demokratike, ekonomike, ligjore dhe institucionale për sigurimin e stabilitetit, zhvillimin ekonomik dhe integrimin gradual të shteteve të Europës Juglindore në Bashkimin Europian;

duke theksuar rëndësinë e një përqasjeje individuale për palët kontraktuese në vlerësimin e arritjeve të tyre në përmbushjen e kriterëve të Kopenhagenit, si dhe vendimet pasuese relevante të Këshillit Europian dhe Këshillit të Bashkimit Europian;

duke rikujtuar përfundimet e Presidencës së Këshillit Europian të Selanikut dhe Samitit të Bashkimit Europian dhe vendeve të procesit të Stabilizim-Asociimit në qershor 2003;

të inkurajuar nga konsensusi i rikonfirmuar mbi zgjerimin, siç u ra dakord në përfundimet e Presidencës së Këshillit Europian në Bruksel, në dhjetor 2006;

duke pasur parasysh Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Europiane dhe shteteve anëtare dhe Republikës së Maqedonisë, të nënshkruar më 9 prill 2001, e cila hyri në fuqi më 4 prill 2004, dhe Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Europiane dhe shteteve anëtare dhe Republikës së Shqipërisë, të nënshkruar më 12 qershor 2006, e cila hyri në fuqi më 1 prill 2009;

duke mirëpritur vendimin e Këshillit Europian të datës 16 dhjetor 2005, që i jep Republikës së Maqedonisë statusin e vendit kandidat, si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave të Bashkimit Europian të datës 16 nëntor 2009, që i kërkon Komisionit Europian të paraqesë opinionin e tij për aplikimin për anëtarësim të Republikës së Shqipërisë;

duke mirëpritur rekomandimin e Komisionit Europian të datës 14 tetor 2009 për hapjen e negociatave të anëtarësimit me Republikën e Maqedonisë;

duke rikujtuar në veçanti, angazhimin e tyre në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për të punuar së bashku për arritjen e paqes, stabilitetit dhe zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm të

rajonit, për të promovuar në mënyrë aktive bashkëpunimin rajonal dhe për ta lidhur këtë lloj marrëveshjeje;

të vendosur për të nxitur zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve të mira dhe për të forcuar bashkëpunimin ekzistues në fushat me interes të ndërsjellë dhe në veçanti në ekonomi, tregti, drejtësi dhe çështjet e brendshme, duke synuar përsheptimin e procesit të përshtatjeve institucionale për të lehtësuar miratimin e legjislacionit dhe praktikave të Bashkimit European;

duke theksuar rëndësinë e angazhimit të Bashkimit European për të kontribuar në zhvillimin e vendeve të rajonit nëpërmjet programeve të ndryshme, instrumenteve të asistencës financiare dhe teknike;

Duke marrë parasysh angazhimin e tyre për tregtinë e lirë në përputhje me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga OBT-ja dhe Marrëveshja e Tregtisë së Lirë për Europën Qendrore (CEFTA);

të vetëdijshëm për rëndësinë e bashkëpunimit dypalësh për arritjen e qëllimeve të programit të punës të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal;

duke pasur parasysh rëndësinë e bashkëpunimit rajonal në sektorë të ndryshëm;

me dëshirën për përmirësimin e dialogut politik të vazhdueshëm për çështjet dypalëshe dhe shumëpalëshe dhe veçanërisht për bashkëpunimin që synon integrimin në strukturat europiane dhe euro-atlantike;

duke marrë parasysh të gjitha marrëveshjet dypalëshe të lidhura ndërmjet palëve kontraktuese;

Kanë rënë dakord si vijon:

KAPITULLI I DIALOGU POLITIK

Neni 1

Palët kontraktuese bien dakord të intensifikojnë dialogun e tyre të vazhdueshëm politik për të nxitur dhe forcuar bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë, në kuadër të anëtarësimit të tyre në Bashkimin European.

Neni 2

Dialogu politik do të zhvillohet gjatë takimeve vjetore të Ministrave të Punëve të Jashtme. Dialogu duhet të nxitë në veçanti bashkëpunimin për çështjet e mëposhtme:

- çështje me interes të përbashkët për palët kontraktuese në kuadër të procesit të Stabilizim-Asociimit;

- çështje me interes të ndërsjellë në kuadër të procesit të anëtarësimit të tyre në Bashkimin European;

- çështje që lidhen me zbatimin e politikës së jashtme dhe të sigurisë së përbashkët të Bashkimit European;

- çështje që lidhen me luftën kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar;

- çështje që lidhen me paqen dhe stabilitetin në rajon dhe përmirësimin e bashkëpunimit rajonal;

- çështje që lidhen me politikën e sigurisë së energjisë në rajon dhe Europë, lufta kundër ngrohjes globale e ndryshimeve klimaterike dhe mbrojtja e mjedisit;

- çështje të tjera me interes të ndërsjellë.

Dialogu mund të zhvillohet, gjithashtu, përmes takimeve të përfaqësuesve të nivelit të lartë të Ministrive të Punëve të Jashtme.

Palët kontraktuese do të promovojnë bashkëpunimin ndërmjet dy Ministrive të Punëve të Jashtme.

Palët janë të hapura për dialog politik me shtetet e tjera të përfshira në procesin e Stabilizim-Asociimit, si edhe me shtete të tjera në procesin e afrimit dhe anëtarësimit në Bashkimin European.

Neni 3

Palët kontraktuese do të forcojnë, gjithashtu, dialogun dhe bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse për integrimin european, veçanërisht Ministrisë së Integritit European të Republikës së Shqipërisë dhe Sekretariatit për Çështjet Europiane të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, duke përfshirë mbledhje vjetore të ministrave përkatës të integritit european.

Në kuadër të këtij dialogu dhe bashkëpunimi, palët kontraktuese këshillohen me njëra-tjetrën dhe shkëmbejnë:

- informacion për reformën ligjore dhe harmonizimin e legjislacionit të brendshëm me *acquis* të Bashkimit Europian-praktikat dhe ndryshimet në praktikë;
- informacion për procesin e përkthimit të *acquis* së Bashkimit Europian, metodat dhe terminologjia;
- informacion mbi tendencat aktuale dhe në zhvillim në procesin e afrimit dhe anëtarësimit në Bashkimin Europian;
- informacion për menaxhimin e instrumentit për asistencën e paraanëtarësimit (IPA) dhe çdo asistencë tjetër të huaj që lidhet me BE-në;
- ekspertë të fushave me interes të ndërsjellë;
- asistencë teknike dhe administrative.

Neni 4

Palët kontraktuese do të inkurajojnë bashkëpunimin e vazhdueshëm ndërmjet parlamenteve, veçanërisht ndërmjet Komisioneve për Politikën e Jashtme dhe Integrimin Europian.

KAPITULLI II BASHKËPUNIMI EKONOMIK DHE TREGTAR

Neni 5

Palët kontraktuese do të bashkëpunojnë për të siguruar përputhjen me të gjitha dispozitat e planifikuara për miratim në fushën e tregtisë së lirë, dhe për të realizuar harmonizimin e sistemit të doganave, duke ndihmuar kështu në zbatimin e Marrëveshjes për Amendimin dhe Aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë për Europën Qendrore, të nënshkruar në Bukuresht më 19 dhjetor 2006.

Bashkëpunimi në veçanti përfshin:

- ndërfunksionimin e mundshëm të sistemeve të teknologjisë së informacionit të doganave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë, si dhe përdorimin e Dokumentit Unik Administrativ (SAD);
- zhvillimin dhe zbatimin e sistemit të standardizuar të paralajmërimit të hershëm (EWS) për monitorimin e lëvizjeve të mallrave sensitive (d.m.th. duhani, alkooli, nafta dhe produktet e naftës);
- përmirësimin dhe thjeshtimin e inspektimeve dhe formaliteteve që lidhen me transportin e mallrave;
- shkëmbimin e nëpunësve ndërlidhës për një periudhë të kufizuar kohe, sipas modaliteteve të pranuar bashkërisht;
- trajnimin e doganierëve.

Pa cenuar bashkëpunimin e mëtejshëm të parashikuar në këtë marrëveshje dhe, në veçanti, nenet 9, 10 dhe 11, asistencë e ndërsjellë ndërmjet autoriteteve doganore përkatëse të palëve kontraktuese do të vazhdojnë në përputhje me dispozitat e shtojcës 5 mbi Asistencën e Ndërsjellë Administrative në Çështjet e Doganave referuar në nenin 14, paragrafët 2 dhe 3 të marrëveshjes për Amendimin dhe Aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Europës Qendrore, nënshkruar në Bukuresht më 19 dhjetor 2006, dhe marrëveshjes ndërmjet Qeverisë Maqedonase dhe Qeverisë Shqiptare për Asistencën e Ndërsjellë dhe bashkëpunimin ndërmjet administratave të tyre doganore, të nënshkruar në Shkup, më 15 janar 1998.

Neni 6

Palët kontraktuese do të marrin parasysh mundësitë për forcimin e bashkëpunimit ekonomik, veçanërisht në fushat e mëposhtme me interes të ndërsjellë:

- industrinë, veçanërisht industrinë e tekstileve dhe atë kimike, si dhe produktet farmaceutike;
- bujqësinë dhe industrinë ushqimore, në veçanti në fushën e tregtisë së ndërsjellë të frutave dhe perimeve të freskëta, mishit dhe produkteve të mishit, verës dhe prodhimeve alkoolike, si dhe në industrinë e duhanit;

- bashkëpunimin midis ndërmarrjeve në sektorin e energjetikës, përmirësimin dhe zgjerimin e rrjeteve kombëtare të transmetimit të energjisë elektrike dhe naftës-jellësve dhe gazsjellësve, ndërlidhjen e tyre brenda rrjeteve transrajonale dhe transeuropiane, transferimin e teknologjisë dhe ekspertizës, shqyrtimi i ndikimit të prodhimit dhe konsumit të energjisë në mjedis dhe përdorimin e burimeve të energjisë së rinovueshme;

- bashkëpunimin në sektorin e transportit, përmirësimin dhe zgjerimin e rrjetit rrugor e hekurudhor dhe infrastrukturës ekzistuese, lidhja e tyre me rrjetet transrajonale dhe transeuropiane.

- bashkëpunimin në sektorin e turizmit me synimin për të rritur numrin e turistëve që shkëmbehen ndërmjet dy vendeve me anë të shkëmbimit të informacionit dhe ekspertizës, investimeve në infrastrukturën turistike, lidhjeve më të mira të transportit, organizimin e aktiviteteve të përbashkëta dhe zhvillimin e programeve dhe projekteve të përbashkëta për turizmin.

Neni 7

Palët kontraktuese do të sigurojnë mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, duke përfshirë masat për dhënien dhe zbatimin e këtyre të drejtave që përputhen me standardet ndërkombëtare.

Për qëllimet e kësaj marrëveshjeje, mbrojtja e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe tregtare do të kryhet në përputhje me nenet 37, 38 dhe 39 të Marrëveshjes për Amendimin dhe Aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë për Europën Qendrore, marrëveshjen e OBT-së për aspektet tregtare që lidhen me të drejtat e pronësisë intelektuale dhe Konventën Europiane për Patentat.

KAPITULLI III

LËVIZJA E PUNËTORËVE DHE KAPITALIT, KRIJIMI DHE OFRIMI I SHËRBIMEVE

Neni 8

Për sa i përket lëvizjes së punëtorëve dhe kapitalit, krijimit dhe ofrimit të shërbimeve, palët kontraktuese do t'i sigurojnë njëra-tjetrës nivel të njëjtë lëshimesh në përputhje me marrëveshjet e lidhura mes tyre.

Lëvizja e punëtorëve do të rregullohet nga një marrëveshje dypalëshe që merr në konsideratë mundësitë e punësimit që ofron tregu i punës në secilën palë kontraktuese.

Punëtorët migrantë ligjërisht të punësuar në territoret e palëve kontraktuese, nuk do të diskriminohen për asnjë lloj arsyeje për sa i përket statusit të punësimit, kushteve të punës, pagës apo pushimeve nga puna.

Të drejtat për sigurime shoqërore në lidhje me sigurimin kundrejt rreziqeve të veçanta (sigurimi i shëndetit, sigurimi i pensionit dhe për paaftësinë në punë, sigurimi ndaj papunësisë), do të rregullohen me anë të një marrëveshjeje për sigurimet shoqërore ndërmjet palëve kontraktuese.

Përgjegjësia për negocimin e marrëveshjeve të veçanta i takon autoriteteve shtetërore kompetente.

Neni 9

Palët kontraktuese do të lehtësojnë lëvizjen e lirë të kapitalit dhe ushtrimin e së drejtës së krijimit të ndërmarrjeve, dhe do të sigurojnë stimuj dhe mbrojtje të përshtatshme për këtë qëllim. Pagesat rrjedhëse ndërmjet palëve kontraktuese do të kryhen në përputhje me dispozitat e Statusit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, në valutë të këmbyeshme sipas praktikës së zakonshme bankare ndërkombëtar.

Neni 10

Palët kontraktuese bien dakord të inkurajojnë bashkëpunimin e ndërsjellë në ofrimin e shërbimeve, sipas dispozitave përkatëse të Marrëveshjes së Përgjithshme për Tregtinë në Shërbime (GATS) dhe Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT).

KAPITULLI IV
HARMONIZIMI I LEGJISLACIONIT ME *ACQUIS COMMUNITAIRE*

Neni 11

Duke synuar procesin e anëtarësimit të tyre në Bashkimin Europian, palët kontraktuese kanë theksuar rëndësinë e harmonizimit të ligjeve të tyre ekzistuese ose që do të miratohen në të ardhmen, me *acquis* të Bashkimit Europian, dhe do të bashkëpunojnë përmes:

- shkëmbimit të informacionit mbi procesin e harmonizimit të legjislacionit me *acquis* të Bashkimit Europian;
- shkëmbimit të informacionit mbi legjislacionin kombëtar dhe praktikën legjislative;
- shkëmbimit të informacionit mbi procesin e përkthimit të *acquis* të Bashkimit Europian;
- organizimit të mbledhjeve të ekspertëve, trajnimeve, seminareve dhe formave të tjera të përgatitjes profesionale dhe shkëmbimit të ekspertizës.

KAPITULLI V
BASHKËPUNIMI NË FUSHAT E DREJTËSISË DHE ÇËSHTJEVE TË BRENDSHME

Neni 12

Palët kontraktuese bien dakord të intensifikojnë bashkëpunimin në fushat e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme, në veçanti në lidhje me politikën e azilit, migrimin, ripranimin, trafikimin e qenieve njerëzore, regjimin e vizave, pastrimin e parave, korrupsionin, kontrabandën, tregtinë e paligjshme të lëndëve narkotike dhe armëve, luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar, reformën në drejtësi dhe shtetin e së drejtës. Brenda kufirit të këtij bashkëpunimi, palët kontraktuese do të konsultohen me njëra-tjetrën dhe shkëmbejnë:

- informacion mbi legjislacionin, reformën legjislative – praktikën dhe ndryshimet në praktikën legjislative;
- informacion mbi tendencat aktuale dhe në zhvillim;
- ekspertë në fushat me interes të ndërsjellë;
- asistencë teknike dhe administrative.

Me qëllim që të nxitin bashkëpunimin në fushat e mësipërme, palët kontraktuese mund të krijojnë grupe të përbashkëta pune.

Neni 13

Palët kontraktuese bien dakord që të bashkëpunojnë:

- në fushën e sistemeve të azilit, me qëllim që të përmirësojnë standardet legjislative dhe administrative në përputhje me detyrimet e tyre ndërkombëtare të marra përsipër, në veçanti, Konventës mbi Statusin Ligjor të Refugjatëve të vitit 1951, protokollin e kësaj Konvente mbi Statusin Ligjor të Refugjatëve të vitit 1967 dhe Konventën Europiane mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut. Ky bashkëpunim do të përfshijë, gjithashtu, shkëmbime periodike të informacionit mbi statistikat e azilkërkuesve;

- në fushën e menaxhimit të migracionit, me qëllim që të ecet drejt një përafrimi gradual të legjislacionit të tyre përkatës me *acquis* të Bashkimit Europian. Palët kontraktuese do të shkëmbejnë veçanërisht informacion mbi reformën legjislative dhe mbajnë shkëmbim të rregullt të informacionit mbi migracionin e ligjshëm, si dhe të dhënat mbi migracionin e paligjshëm, duke përfshirë punësimin e paligjshëm dhe migracionin transit;

- në fushën e parandalimit dhe kontrollit të imigrimit të paligjshëm, palët kontraktuese do të vazhdojnë t'u përmbahen rregullave të marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë mbi ripranimin e personave dhe protokollit mbi zbatimin e kësaj marrëveshjeje;

- në fushën e menaxhimit të integruar të kufijve, me qëllim që të ecet drejt përafrimit gradual të legjislacionit të tyre përkatës me *acquis* të Bashkimit Europian dhe sigurimit të menaxhimit dhe kontrollit të kufirit në një nivel të lartë. Palët kontraktuese do të vazhdojnë t'u përmbahen rregullave të marrëveshjeve ekzistuese dhe të forcojnë edhe më tej bashkëpunimin e tyre.

Neni 14

Palët kontraktuese bien dakord të bashkëpunojnë në parandalimin e përdorimit të sistemeve të tyre financiare për pastrimin e pasurive nga aktivitetet kriminale, veçanërisht pasuritë e krimit të organizuar.

Bashkëpunimi në këtë fushë do të përqendrohet në zbatimin e rregullave dhe funksionimin efikas të standardeve dhe mekanizmave përkatës ndërkombëtarë për të luftuar pastrimin e parave.

Neni 15

Palët kontraktuese do të krijojnë një kuadër bashkëpunimi, duke synuar luftimin dhe parandalimin e aktiviteteve kriminale dhe të paligjshme, veçanërisht krimin e organizuar, të tillë si:

- trafikimin e qenieve njerëzore;
- aktivitetet kriminale në fushën e krimit ekonomik, veçanërisht korrupsionin, transaksionet e paligjshme dhe kontrabandën që ka të bëjë me mallra të tilla, si: mbetjet e rrezikshme, materialet radioaktive, falsifikimin dhe produktet e falsifikuara;
- trafikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope;
- kontrabandën e mallrave me akcizë;
- kalimin e paligjshëm të kufirit;
- kontrabandën e automjeteve të luksit, të vjedhura;
- kontrabandën e armëve;
- terrorizmin;
- falsifikimin e dokumenteve;
- falsifikimin e instrumenteve të pagës dhe letrave me vlerë;
- mashtrimin me kartat bankare të falsifikuara;
- falsifikimin e euros.

Neni 16

Brenda fushës së veprimit të fuqive të kompetencave të tyre përkatëse, palët kontraktuese do të bashkëpunojnë në rritjen e efikasitetit të politikave dhe masave për të luftuar furnizimin dhe trafikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope dhe prekursorëve, dhe në uljen e abuzimit me lëndët narkotike dhe substancat e tjera psikotrope.

Neni 17

Duke synuar ngritjen e kapaciteteve të sistemeve të administratës dhe gjyqësorit, dhe konsolidimin e shtetit të së drejtës dhe pavarësinë e gjyqësorit, palët kontraktuese mund të bashkëpunojnë në fushën e trajnimit të profesionistëve të sistemit të drejtësisë.

KAPITULLI VI BASHKËPUNIMI NË FUSHA TË TJERA

Neni 18

Palët kontraktuese do të marrin masa që synojnë luftimin e ndryshimeve klimatike dhe nxitjen e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes së mjedisit, veçanërisht në menaxhimin e përbashkët të ujërave ndërkombëtare, mbrojtjen e biodiversitetit, mbrojtjen e ajrit, parandalimin e trafikimit të mbetjeve dhe përafrimin e legjislacionit me *acquis* të Bashkimit Europian për të realizuar një kuadër ligjor të unifikuar për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit.

Palët kontraktuese do të nxitin bashkëpunimin ndërmjet njërive të qeverisjes vendore në fushën e funksionimit të qeverisjes vendore, përgatitjen e njërive të qeverisjes vendore për anëtarësimin në Bashkimin Europian, aksesin dhe përdorimin e fondeve nga instrumentet financiare të Bashkimit Europian, nxitjen e zhvillimit rajonal dhe bashkëpunimit territorial, bashkëpunimin ndërmjet rajoneve planifikuese dhe ndërmjet institucioneve dhe organeve rajonale.

Palët kontraktuese do të nxitin bashkëpunimin sipas nevojave edhe në fusha të tjera me interes të ndërsjellë.

KAPITULLI VII DISPOZITA INSTITUCIONALE, TË PËRGJITHSHME DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 19

Kjo marrëveshje krijon mekanizmat institucionalë në vijim:

- takimin e Ministrave të Punëve të Jashtme në kuadër të dialogut politik duke përfshirë zhvillimin e bashkëpunimit për të trajtuar çështjet që kanë të bëjnë me anëtarësimin e palëve kontraktuese në Bashkimin Europian, si dhe me çështjet me interes për rajonin, dhe me politikën e përbashkët të jashtme dhe sigurisë së Bashkimit Europian;

- takimin e ministrave të Integritimit Europian për të trajtuar çështjet që kanë të bëjnë me anëtarësimin e palëve kontraktuese në Bashkimin Europian;

- Komiteti i Përbashkët i përbërë nga përfaqësues të ministrive të Punëve të Jashtme përkatëse, të cilët do të mbikëqyrin zbatimin e kësaj marrëveshjeje në nivel operacional dhe do të bëjnë përgatitjet e domosdoshme për takimet e ministrave të Punëve të Jashtme, në bashkëpunim me përfaqësuesit nga ministritë e tjera;

- grupet e përbashkëta të punës për të nxitur bashkëpunimin në fusha të veçanta.

Neni 20

Palët kontraktuese do të konsultohen dhe këshillohen me Bashkimin Europian për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet tyre.

Komisioni Europian mund të ftohet të ndjekë me cilësinë e vëzhguesit takimet e organizuara sipas kësaj marrëveshjeje.

Neni 21

Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar kohe.

Secila nga palët kontraktuese mund ta denoncojë këtë marrëveshje, duke informuar palën tjetër të paktën gjashtë muaj përpara përmes kanaleve diplomatike.

Neni 22

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së notës diplomatike të fundit, me anë të së cilës palët kontraktuese informojnë njëra-tjetrën se janë përmbushur kërkesat e përcaktuara nga legjislacioni i tyre kombëtar për hyrjen e saj në fuqi.

Neni 23

Kjo marrëveshje nuk cenon të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga traktatet në fuqi për palët kontraktuese.

Përgatitur në Tiranë, më 17.3.2011, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, maqedonase dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëjloj autentike. Në rast mospërputhjes në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

VENDIM
Nr.509, datë 6.7.2011

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS QENDËR FIER TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Qendër Fier të qarkut të Fierit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 151 (njëqind e pesëdhjetë e një) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 1043 (një mijë e dyzet e tre).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Qendër Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Qendër Fier

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-132, 1008-1028	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
133	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
134-145	Varrezat publike	Në pronësi
146-168	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile.	Në pronësi
169	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
275-283	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
284-288, 1000, 1001	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
289-306	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
316-929	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
935, 948, 950, 951, 959, 992-999, 1030	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproductive)	Në pronësi
1029, 1031-1035	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
960-971, 1036-1037	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

VENDIM
Nr.510, datë 6.7.2011

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
BASHKISË PEQIN TË QARKUT TË ELBASANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Peqin të qarkut të Elbasanit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 57 (pesëdhjetë e shtatë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 344 (treqind e dyzet e katër).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Peqin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Bashkia Peqin

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
155-158	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
163	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
142-145, 341-343	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
1-95	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
96-107, 188-230, 231-334, 339-340	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
113-138, 172, 173, 335-337	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
169-171	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive). Sip.52.3 ha tokë bujqësore, në zonat kadastrale nr.2908, 2093 dhe 1112, i është dorëzuar AKKP-së.	Në përdorim
146, 344	Prona që përdoren në fushën administrative	Në pronësi
338	Varrezat publike	Në pronësi

VENDIM
Nr.511, datë 6.7.2011

PËR ADOPTIMIN E EUROKODEVE TË NDËRTIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4 e 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, dhe të nenit 4 të ligjit nr.9870, datë 4.2.2008 “Për standardizimin”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Adoptimin e eurokodeve-standardeve europiane të projektimit, së bashku me anekset kombëtare (Eurokodi 0-3), për plotësimin e kërkesave themelore që kanë të bëjnë me: rezistencën dhe qëndrueshmërinë mekanike; sigurinë nga zjarri; higjienën, shëndetin dhe mjedisin; sigurinë në përdorim; mbrojtjen nga zhurmat; kursimin e energjisë dhe ruajtjen e ngrohtësisë.

2. Shpenzimet operative prej 20 (njëzet) milionë lekësh për përkthimin, redaktimin, përshtatjen dhe hartimin e anekseve kombëtare të eurokodeve, të përballohen nga shpenzimet korente të miratuara për Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit, në programin “Strehimi dhe urbanistika”, të cilat t’i kalojnë Entit Kombëtar të Banesave për këtë qëllim.

3. Ngarkohet Enti Kombëtar i Banesave për administrimin e fondeve dhe ndjekjen e procedurave, ligjore dhe nënligjore në fuqi, për kryerjen e shërbimit, sipas pikës 2 të këtij vendimi.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, me kërkesë të EKB-së, vë në dispozicion të grupeve të punës dokumentacionin e plotë dhe të veçantë të nevojshëm të eurokodeve.

5. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.513, datë 6.7.2011

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT, TË FORMËS “BOT”, TË LIDHUR
NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGETIKËS DHE
BASHKIMIT TË SHOQËRIVE “CARAGLIO” SRL & “HERTIS” SHPK, PËR NDËRTIMIN E
HIDROCENTRALEVE NË RRJEDHËN E LUMIT SHKUMBIN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 4, e 27 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoriteti kontraktues, dhe bashkimit të shoqërive “Caraglio” s.r.l. & “Hertis” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentraleve në rrjedhën e lumit Shkumbin, rrethi Librazhd, sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.518, datë 6.7.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË DOKUMENTACIONIT DHE TË PROCEDURAVE
PËR PAJISJEN, REFUZIMIN, RIPËRTËRITJEN E ANULIMIN E LEJES SË PUNËS TË TIPIT
C/PSH**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 48, pika 2, 60, pika 2, dhe 67, pika 1 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 "Për të huajt", me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të huajt i jepet leje pune e tipit C/PSH, si punëtor shtëpiak, nëse plotëson kriteret, si më poshtë vijon:

a) ka një kontratë pune me një punëdhënës në përputhje me formimin e tij;

b) ka hyrë ose qëndron në mënyrë të ligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, që do të thotë me vizë, të llojeve të përcaktuara në nenet 13 e 14 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 "Për të huajt".

2. Të huajt i ripërtërihet leja e punës e tipit C/PSH, si punëtor shtëpiak, nëse:

a) ka një kontratë pune të vlefshme në përputhje me punën e ushtruar prej tij, si punëtor shtëpiak, në rajonin gjeografik, ku ka përfituar lejen e mëparshme të punës, por jo domosdoshmërisht me punëdhënësin, që ka përfituar lejen e parë të tipit C/PSH;

b) është me qëndrim të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë;

c) ka një vërtetim nga organet tatimore se ka shlyer të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore në Republikën e Shqipërisë.

3. Kërkesa për pajisjen e të huajt me leje pune të tipit C/PSH bëhet nga:

a) i huaji;

b) punëdhënësi me të cilin i huaji ka një kontratë pune;

c) personi i autorizuar nga punëdhënësi.

4. Personat e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, për pajisjen e të huajt, për herë të parë me leje pune të tipit C/PSH, paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesën e të huajt me të dhënat personale, sipas formularit që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) vendimin e gjykatës/ekstraktin e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të personit fizik/juridik ose çdo personi tjetër, punëdhënës ku ai do të punësohet;

c) kopjen origjinale të kontratës individuale të punës, e cila duhet të përmbajë, përveç elementeve të përcaktuara në pikën 3 të nenit 21 të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, edhe kushtet e akomodimit dhe të ushqimit të punëtorit shtëpiak;

ç) vërtetimin nga punëdhënësit/organet tatimore për të ardhurat mujore të familjes së punëdhënësit të punëtorit shtëpiak, të cilat duhet të jenë pesë herë më shumë se paga që do të shpërblehet punëtori shtëpiak sipas kontratës së punës;

d) kopjen e pasaportës së punëdhënësit;

dh) kopjen e pasaportës së punëmarrësit;

e) autorizimin nga punëdhënësi për personin e autorizuar;

ë) pesë fotografi;

f) dëshminë për formimin profesional të punëmarrësit, nëse ka të tillë për vendin e punës, sipas legjislacionit në vendin e origjinës ose të vendit ku ai është me qëndrim të ligjshëm.

5. Personat e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, për pajisjen e të huajt me leje pune të ripërtëritur të tipit C/PSH, paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesën e të huajt me të dhënat personale, sipas formularit që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) kopjen e kontratës individuale të punës, e cila duhet të përmbajë, përveç elementeve të përcaktuara në pikën 3 të nenit 21 të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, edhe kushtet e akomodimit dhe të ushqimit të punëtorit shtëpiak;

c) vërtetimin nga punëdhënësit/organet tatimore për të ardhurat mujore të familjes së punëdhënësit të punëtorit shtëpiak, të cilat duhet të jenë pesë herë më shumë se paga që do të shpërblehet punëtori shtëpiak sipas kontratës së punës;

ç) autorizimin nga punëdhënësi për personin e autorizuar;
d) pesë fotografi;
e) vërtetimin nga organet tatimore për shlyerjen e detyrimeve për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, të përcaktuara në shkronjën “c” të pikës 2 të këtij vendimi, për pagesën e kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punëtorin shtëpiak.

6. Nëse punëtori shtëpiak, i cili kërkon të pajiset me leje pune të ripërtëritur të tipit C/PSH, ndryshon punëdhënësin, personat e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, për ripërtëritjen e lejes së punës, paraqesin dokumentacionin e përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi.

7. Personat e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, paraqesin kërkesën dhe dokumentacionin e përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi:

a) në zyrën përkatëse të punësimit, në territorin e së cilës ka vendbanimin punëdhënësi tek i cili do të punësohet, nëse është me qëndrim të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) pranë përfaqësisë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, në vendin e tij të origjinës.

8. Zyra përkatëse e punësimit, kur kërkesa paraqitet pranë tyre, pasi shqyrton dokumentacionin e paraqitur dhe vlerëson se ai nuk është në përputhje me kërkesat e pikës 4 të këtij vendimi, i kërkon të huajit plotësimin e tij, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune.

9. Zyra përkatëse e punësimit, pas paraqitjes së kërkesës nga personat e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, verifikon:

a) shlyerjen e detyrimeve në organet tatimore, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore nga punëdhënësi, si individ;

b) shlyerjen e detyrimeve në organet tatimore, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të punëdhënësit, për veprimtarinë ekonomike që ai ushtron;

c) nëse punëdhënësi ka zbatuar legjislacionin e punës ose ka shlyer shkeljet e konstatuara në aktin e fundit të inspektimit në punë, të nxjerrë nga Drejtoria Rajonale e Inspektimit në Punë.

10. Zyra përkatëse e punësimit e pajis të huajin, për herë të parë, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, me leje pune njëvjeçare të tipit C/PSH, nëse:

a) dokumentacioni i paraqitur është i plotë apo pas plotësimit të tij nga personat e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, brenda afatit të përcaktuar;

b) përmbushen kriteret e përcaktuara në pikat 1 dhe 9 të këtij vendimi;

c) i huaji paraqet, në çastin e marrjes së lejes së punës së tipit C/PSH dokumentin e regjistrimit në organet tatimore, shoqëruar me NIPT-in e punëdhënësit.

11. Zyra përkatëse e punësimit ia kthen kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur të huajit, nëse ai nuk e ka plotësuar atë brenda afatit të përcaktuar në pikën 8, të këtij vendimi.

12. Zyra përkatëse e punësimit ia refuzon kërkesën për pajisje me leje pune të tipit C/PSH, punëmarrësit, i cili, megjithëse ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar, vlerësohet se:

a) nuk plotëson kriteret e përcaktuara në pikat 1 dhe 9 të këtij vendimi;

b) pozicioni i punës që i ofrohet, në rajonin gjeografik ku ndodhet punëdhënësi, mund të plotësohet nga kategoritë e përcaktuara në pikën 2 të nenit 40 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008;

c) është në kushtet e parashikuara në pikën 20 të këtij vendimi.

13. Nëse kërkesa është paraqitur pranë përfaqësisë diplomatike të Republikës së Shqipërisë në vendin e origjinës të së huajit, kjo e fundit nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme ia përcjell dokumentacionin drejtorisë përgjegjëse për çështjet e migracionit në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

14. Drejtoria përgjegjëse për çështjet e migracionit në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ia përcjell dokumentacionin e paraqitur zyrës përkatëse të punësimit, sipas kompetencës territoriale që ato kanë.

15. Zyra përkatëse e punësimit, për pajisjen/refuzimin të huajit të lejes së punës të tipit C/PSH, ndjek procedurat e përcaktuara në pikat 8, 9, 10, 11 dhe 12 të këtij vendimi.

16. Zyra përkatëse e punësimit, nëpërmjet drejtorisë përgjegjëse për çështjet e migracionit në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, përcjell në Ministrinë e Punëve të Jashtme njoftimin për pajisjen/refuzimin e lejes së punës të tipit C/PSH.

17. Ministria e Punëve të Jashtme njofton përfaqësinë diplomatike të Republikës së Shqipërisë në vendin e origjinës së të huajit për pajisjen/refuzimin e lejes së punës të tipit C/PSH.

18. Personat e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, për ripërtëritjen e lejes së punës të tipit C/PSH, paraqesin 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para mbarimit të afatit të lejes ekzistuese, kërkesën dhe dokumentacionin e përcaktuar në pikën 5 ose 6 të këtij vendimi, në zyrën përkatëse të punësimit, në territorin e së cilës punëdhënësi, pranë të cilit do të punësohet, ka vendbanimin.

19. Zyra përkatëse e punësimit për ripërtëritjen e lejes së punës të tipit C/PSH apo refuzimin e saj brenda një periudhe prej 30 (tridhjetë) ditësh pune, ndjek procedurat e parashikuara në pikat 8, 9, 10, 11 dhe 12 të këtij vendimi, ndërsa vlerësimi për kriteret dhe dokumentacionin do të bëhet sipas përcaktimeve në pikat 2, 5 ose 6, 9 dhe 20 të këtij vendimi.

Afati i vlefshmërisë së lejes së ripërtëritje të punës për punëtorët shtëpiakë është njëvjeçar.

20. Të huajt i refuzohet lëshimi i lejes së punës të tipit C/PSH apo ripërtëritja e saj edhe nëse vërtetohet njëra nga situatat e përcaktuara në nenin 63 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008.

21. Të huajt i anulohet leja e punës e tipit C/PSH, nëse vërtetohet njëra nga situatat e përcaktuara në pikën 1 të nenit 64 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit/zyra përkatëse e punësimit, pasi njoftohen nga autoritetet shtetërore përgjegjëse për vërtetimin e njërës nga situatat e përcaktuara në pikën 1 të nenit 64 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”, merr vendim për anulimin e lejes së punës.

22. I huaji, të cilit i refuzohet ose anulohet leja e punës e tipit C/PSH, ka të drejtën e ankimimit, sipas procedurës së përcaktuar në pikën 2 të nenit 65 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008.

23. Leja e punës e tipit C/PSH përfundon nëse plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 44 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008.

24. I huaji, i cili pajiset me leje pune të tipit C/PSH, për herë të parë para marrjes së lejes së punës detyrohet të paguajë tarifën prej 6 000 (gjashtë mijë) lekësh.

25. I huaji, të cilit i ripërtëritet leja e punës e tipit C/PSH, për herë të parë para marrjes së lejes së punës detyrohet të paguajë tarifën prej 3 000 (tre mijë) lekësh.

26. Drejtoria përgjegjëse për çështjet e migracionit në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, monitoron në mënyrë periodike procedurën e ndjekur nga zyrat përkatëse të punësimit për dhënien e lejes së punës të tipit C/PSH.

27. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Punëve të Jashtme, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe zyrat përkatëse të punësimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

FORMULAR KËRKESË PËR LËSHIMIN E LEJES SË PUNËS

Ju lutemi plotësoni formularin e mëposhtëm për lëshimin e lejes së punës, e cila do t’ju lëshohet, brenda ditë pune, nëse përmbushen të gjitha dispozitat e ligjit

APPLICATION FORM FOR ISSUING THE WORK PERMIT

Please complete the following form in order to obtain a Work Permit which will be issued to you within working days. If any of the relevant clauses of the Law are fulfilled

SEKSIONI 1. TË DHËNA MBI PERSONIN QË PARAQET KËRKESËN SECTIONI 1. ABOUT THE PERSON SUBMITTING THE REQUEST

Kjo kërkesë paraqitet:

The request is to be submitted:

Personalisht

In person

Nga përfaqësuesi i autorizuar

Authorized Representative
Nga punëdhënësi
Employer

Emri: _____
First name

Mbiemri: _____
Last name

Emri i babait: _____
Father's name

Shtetësia: _____
Citizenship

Jeni shtetas i Bashkimit European?
Are you a national of European Union

Po Jo

Datëlindja: _____
(dita, muaj, vit)

Date of birth (day, month, year)

Vendlindja: _____
(shteti, rajoni, komuna)

(country, region, commune/province)

Shtetësia: _____
Citizenship

Kombësia (nëse është e rëndësishme): _____
Nationality (if relevant)

Gjinia: Mashkull Femër
Gender: Male Female

Gjendja civile: I/e pamartuar I/e martuar I/e divorcuar

Marital status: Single Married Divorced

A keni pasur më parë një leje pune shqiptare? Po Jo
Have you ever been issued an Albanian Work Permit?

Telefon: _____

E-mail: _____
Mailing address

Pasaportë: E zakonshme Shërbimi Diplomatiqe
Passport: Ordinary Service Diplomatic

Dokument tjetër i njohur nga Republika e Shqipërisë si i barasvlershëm:
Other Travel Documents Recognized by the Republic of Albania

Data e skadimit të vlefshmërisë së pasaportës: _____
Date of Passport expiry

Lëshuar nga: _____
Issuing authority

Persona në ngarkim në vendin e origjinës:

Family members in charge in the country of origin
Bashkëshort/e Fëmijë të rritur Prindër
Spouse Children Parents

Data e hyrjes së fundit në territorin e Republikës së Shqipërisë, përmes pikës së kontrollit të kalimit të kufirit (PKKK): _____

Last Entry date to Albanian
Through Border Checkpoint

SEKSIONI 2. TË DHËNA MBI VIZËN
SECTION 2. VISA DETAILS

Data e hyrjes së fundit në Shqipëri: _____

Last Entry date to Albania

Pika e kalimit të kontrollit kufitar: _____

Border checkpoint

Numri i vizës: _____

Visa number

Tipi i vizës: _____

Type of Visa

Me një hyrje: _____

Number of entries (1)

Me shumë hyrje (Multiple): _____

Shënime/motive të vizës së hyrjes: _____

Remarks/Reason/Motive of Entry Visa

Kohëzgjatja e vizës: _____

Duration of Stay

E vlefshme nga

Valid from: _____

(dita, muaj, viti)

(day, month, year)

Deri më: _____

(dita, muaj, viti)

Unitil

(day, month, year)

SEKSIONI 3. TË DHËNA MBI STATUSIN E KANDIDATIT
SECTION 3. ABOUT CANDIDATE STATUS

Punëmarrës/e

Employee

Punëdhënës/e

Employer

I/e vetëpunësuar/ë

Self-employed

Investitor/e

Investitor

SEKSIONI 4. TIPI I KËRKESËS
SECTION 4. TYPE OF THE REQUEST

Leje pune fillestare

Initial Work permit

Ripërtëritje e lejes së punës

Renovation of Work Permit

Azhurnimi i lejes së punës

Adjournment of Work permit

Dublikimi i lejes së punës

Dublication of Work permit

Shndërrimi i lejes së punës

Conversion of Work Permit

Data e lëshimit të lejes së punës, apo ekzistuese: _____

Issuing date of the first, or present Work Permit (dita, muaji, viti)
(day, month, year)

Data e përfundimit të lejes ekzistuese të punës: _____

Expiry date of the present Work Permit (dita, muaji, viti)
(day, month, year)

SEKSIONI 5. TË DHËNA MBI PERSONIN/AT E KONTAKTIT

SECTION 5. CONTACT DETAILS

Telefon: _____

Telephone: _____

Fax: _____

E-mail: _____

Web page: _____

Adresa aktuale: _____

Present Address

Rajoni/Qyteti _____

Region/City/Town

Post Code/Zip Code: _____

SEKSION 6. TË DHËNA MBI VENDIN E PUNËS PËR PUNËMARRËSIN

SECTION 6. ABOUT THE JOB FOR THE EMPLOYEE

Emërtimi i vendit të punës

Job Title

Përshkrimi i shkurtër i vendit të punës/aftësi të përdorura/përgjegjësi

Short job description/Skills Used/Responsibilities

Ndërmarrja që punëson:

Employing Company _____

Niveli i pagës: _____

Salary level

Data e menduar e fillimit të punës: _____

Intended start date of work (dita, muaji, viti)
(day, month, year)

Data e menduar e përfundimit të punës: _____

Intended finish date of work (dita, muaji, viti)
(day, month, year)

Shpjegoni shkurtimisht se përse e keni pasur të vështirë të gjeni shtetas shqiptarë, apo rezidentë të huaj, të ligjshëm për zënieën e këtij vendi të lirë pune?

Explain shortly why it is difficult to find someone from the resident labor market, or foreign legal resident for this vacancy?

Shpjegoni shkurtimisht se ç'keni bërë për të reklamuar (bërë publik, të njohur) këtë vend pune?
Explain shortly what have you done to publicly advertise this vacancy.

Jepni hollësira mbi njoftimet në internet dhe median e shkruar, duke përfshirë edhe datat.
Details about website and adverts in print publications including dates.

Shpjegoni shkurtimisht se si mësuar për vendin e lirë të punës.
Explain shortly how did the candidate/employer find out about the vacancy?

(Për punëdhënësin) Shpjegoni shkurtimisht se si e zgjodhët kandidatin punëmarrës.
(For the employer) Explain shortly how did you select the potential employee?

- Me njohje të drejtpërdrejtë
By direct acquaintance
- Me rekomandim/referim
By recommendation/reference
- Përmes listave të punëkërkesve pranë zyrës rajonale/vendore të punësimit
Consulting the lists of jobseekers atvarios Regional-Local Employment Office

SEKSIONI 7. TË DHËNA PËR TË VETËPUNËSUARIN SECTION 7. ABOUT THE SELF-EMPLOYED

Person juridik
Legal person/entity

Person fizik
Natural person

Lloji i biznesit: _____
Type of business

Kodi fiskal/NIPT-i: _____
Fiscal Code/NIPT

Numri i sigurimeve shoqërore dhe data e regjistrimit: _____
Social Insurance number and date of registration: _____
(dita, muaji, viti)
(day, month, year)

Vendimi i gjykatës për njohjen e biznesit ose: _____
Court Decision on Business Acknowledgment or:

Ekstrakt nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit: _____
Abstract from National Registration Centre:

SEKSIONI 8. TË DHËNA PËR INVESTITORIN SECTION 8. ABOUT THE INVESTITOR

Person juridik
Legal person/entity

Person fizik
Natural person

Lloji i biznesit: _____
Type of business

Kodi fiskal/NIPT-i: _____
Fiscal Code/NIPT

Numri i sigurimeve shoqërore dhe data e regjistrimit: _____

Social Insurance number and date of registration

(dita, muaji, viti)
(day, month, year)

SEKSIONI 9. TË DHËNA TË PUNËDHËNËSIT
SECTION 9. ABOUT THE EMPLOYER

Person juridik
Legal person/entity

Person fizik
Natural person

Lloji i biznesit: _____
Type of business

Kodi fiskal/NIPT-i: _____
Fiscal Code/NIPT

Numri i sigurimeve shoqërore dhe data e regjistrimit: _____
Social Insurance number and date of registration

(dita, muaji, viti)
(day, month, year)

SEKSIONI 10. KUALIFIKIME ARSIMORE
SECTION 10. EDUCATIONAL ATTAINMENT

1. Kualifikime arsimore
Educational Attainment

Diplomë universiteti
University Diploma

Diplomë kolegji
College Diploma

Diplomë
Any Degree

Shkollë teknike
Technical School Diploma

Të përgjithshme
General education certificate

Të tjera
Others

2. Kualifikime të formimit profesional
Technical/professional qualifications
Certifikata/Diploma
Certificates/Diplomas

Deklaroj se i lexova dhe rashë dakord (në një mendje) me kushtet për lëshimin e lejes së punës plotësisht i vetëdijshëm për pasojat e paraqitjes së të dhënave të rreme, apo jo të vërteta, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

I confirm that I have read and agree to the for the issue of the Work Permit well aware of the consequences for submitting false, or no real data, according to prevailing Albanian legislation in force.

Tarifa për përpunimin dhe lëshimin e lejes së punës është lekë shqiptare, siç përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr....., datë

The cost of processing is Albanian currency (lekë), as determined by the decision of the Council of Ministries.....

(Emri, mbiemri)
Signature

___/___/2011

VENDIM
Nr.521, datë 20.7.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.147, DATË 2.3.2011 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE TË SHPENZIMEVE
BUXHETORE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM, 2012-2014”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 23 e 27 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr.1, bashkëlidhur vendimit nr.147, datë 2.3.2011 të Këshilli të Ministrave, zëvendësohet me lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TAVANET E MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE BUXHETORE NË MILIONË LEKË

Emertimi i Institucionit Buxhetor	viti 2012					viti 2013					viti 2014					
	600-601	602-606	230-232		Transfere per Fondet Speciale ISSH+ISKSH+KP	600-601	602-606	230-232		Transfere per Fondet Speciale ISSH+ISKSH+KP	600-601	602-606	230-232		Transfere per Fondet Speciale ISSH+ISKSH+KP	
	Paga+Sig shoq	Te tjera Korente	Investime/ brendshme	Investime/ huaja		Totali	Paga+Sig shoq	Te tjera Korente	Investime/ brendshme		Investime/ huaja	Totali	Paga+Sig shoq	Te tjera Korente		Investime/ brendshme
1 Presidencia	96	55	15			166	100	57	15		171	103	59	16		177
2 Kuvendi	510	237	100			848	529	244	100		873	547	254	100		901
3 Keshilli Ministrave	180	195	20			394	186	201	20		407	193	209	20		422
4 Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes	792	283	420	1,000		2,495	820	292	430	1,000	2,542	849	303	450	1,000	2,602
5 Ministria e Bujqesise, Ushqim dhe Mbrojt. se Konsum.	1,787	1,934	2,300	900		6,921	1,851	1,992	2,400	1,500	7,743	1,915	2,111	2,500	2,005	8,531
6 Ministria e Puneve Publike, Transport dhe Telekomunik.	1,147	3,010	13,168	28,522		45,847	1,188	3,100	5,262	38,901	48,451	1,229	3,286	5,882	37,333	47,730
10 Ministria e Financave	3,321	1,003	800		1,800	6,923	3,439	1,033	700		7,022	3,559	1,074	750		7,283
11 Ministria e Arsimit dhe Shkences	28,296	7,355	2,600	2,000		40,250	29,300	7,575	2,700	2,000	41,575	30,325	8,007	2,900	4,400	45,633
12 Ministria e Turizmit, Kultures, Rinise dhe Sporteve	964	585	500			2,049	998	603	520		2,121	1,033	627	560		2,220
13 Ministria e Shendetesise	2,434	1,579	2,500	1,000	21,838	29,351	2,521	1,626	2,700	1,500	31,192	2,609	1,719	2,850	1,500	32,392
14 Ministria e Drejtise	4,106	883	450	300	500	6,239	4,251	910	470	405	7,036	4,400	946	500	300	7,646
15 Ministria e Puneve te Jashtme	393	1,714	100			2,207	407	1,765	130		2,302	421	1,836	140		2,397
16 Ministria e Brendshme	11,637	3,360	800	500		16,297	12,154	3,461	900	400	16,915	12,580	3,600	1,100	400	17,680
17 Ministria e Mbrojtjes	7,836	5,433	3,000	1,000	4,500	21,769	8,114	5,559	3,200	1,000	22,423	8,399	5,776	3,300	1,000	23,075
18 Sherbimi Informativ Shteteror	968	260	100			1,318	1,003	257	100		1,360	1,038	258	100		1,406
19 Drejtoria e Radio Televizionit	0	352	50			402	0	353	50		413	0	377	100		477
20 Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave	131	35	10			176	135	37	19		191	140	38	19		197
22 Akademia e Shkences	35	48	1			84	36	49	1		86	37	51	1		89
24 Kontrolli i Larte i Shtetit	219	47	5			271	227	48	5		280	235	50	5		290
25 Ministria e Punes, Cesht. Sociale dhe Shanseve te Bara.	1,154	20,756	150		31,354	53,414	1,195	22,170	150		58,586	1,237	23,484	160		63,674
26 Ministria e Mjedisit, Fytyre dhe Administrimit te Ujrave	948	225	400	420		1,993	981	232	460	520	2,193	1,016	242	500	820	2,577
28 Prokuroria e Pergjithshme	984	258	100			1,342	1,019	266	110		1,394	1,054	276	120		1,450
29 Zyra e Administrimit te Buxhetit Gjyqesor	1,363	255	180			1,798	1,412	263	190		1,864	1,461	273	210		1,944
30 Gjykata Kushtetuese	75	25	3			104	78	26	2		106	81	27	2		110
31 Agjensia Telegrafike Shqiptare	74	14	3			91	77	15	2		93	79	15	2		97
40 Partite Politike	0	219	0			219	0	226	0		226	0	235	0		235
50 Instituti Statistikes	202	145	10			357	209	149	10		368	217	155	10		382
55 Shkolla e Magistratures	26	25	2			54	27	26	2		55	28	27	2		57
56 Fondi i Zhvillimit Shqiptar	0	0	1,000	5,200		6,200	0	0	900	4,700	5,600	0	0	800	4,500	5,300
57 Qendra Kombetare e Kinematografise	9	93	2			103	9	96	2		108	9	99	2		111
63 Keshilli i Larte i Drejtise	58	4	4			66	60	24	4		74	62	25	4		81
66 Avokati i Popullit	69	13	2			84	72	14	2		87	74	14	2		90
67 Komisioni i Sherbimit Civil	32	9	2			44	33	10	2		45	35	10	2		47
73 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	77	21	3			102	80	622	3		705	83	25	3		111
76 Inspektorjati i Larte Kontrollit te Deklarimit te Pasurive	63	21	4			88	65	22	4		91	67	23	4		94
77 Autoriteti i Konkurences	48	9	5			62	50	9	5		64	52	9	5		66
78 Ministria e Integritetit	86	50	16			152	89	52	15		156	92	54	16		162
82 Keshilli Kombetar Kontabilitetit	7	5	1			14	8	6	2		15	8	6	2		16
86 Avokati i Prokurimeve	20	5	2			27	21	5	2		28	22	5	2		29
87 Institucione te tjera Qeveritare	166	530	157	400		1,253	170	289	160	400	1,019	175	260	185	400	1,000
88 Mbeshtetje per shoqerine civile	13	78	2			93	13	81	2		96	14	84	2		100
89 Komisioneri per Mbrojtjen e te Dhenave Personale	34	9	3			46	35	9	2		46	36	9	2		47
91 Komisioneri per Mbrojtjen nga Diskriminimi	25	6	3			34	26	6	2		34	26	6	2		34
92 Instituti i Studimit te Krimeve te Komunizmit	17	11	7			35	17	12	7		36	17	12	7		36

VENDIM
Nr.523, datë 20.7.2011

PËR KOMPENSIMIN E VLERËS SË TAKSËS SË BIZNESIT TË VOGËL, TË PËRDORUR PËR RIMBURSIMIN E PAJISJEVE FISKALE E TË TAKSIMETRAVE, PËR 7 BASHKI DHE 9 KOMUNA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 "Për buxhetin e vitit 2011", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e vlerës së pajisjeve fiskale e të taksimetrave, për njësitë e qeverisjes vendore, 7 (shtatë) bashki dhe 9 (nëntë) komuna, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Fondi në vlerën 47 676 148 (dyzet e shtatë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e dyzet e tetë) lekë përballohet nga Fondi i Kontigjencës, i miratuar në buxhetin e vitit 2011.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Nr.	Emri i NJQV-së	Vlera (në lekë)
1	Bashkia Laç	8,278,000
2	Bashkia Tiranë	20,541,190
3	Bashkia Gramsh	6,616,907
4	Bashkia Ura Vajgurore	948,114
5	Bashkia Ballsh	1,426,250
6	Bashkia Kamëz	5,547,320
7	Bashkia Rrëshen	1,020,750
8	Komuna Qesarat (Tepelenë)	342,982
9	Komuna Gjocaj (Elbasan)	54,625
10	Komuna Ungrej (Lezhë)	44,000
11	Komuna Roshnik	24,375
12	Komuna Qendër (Fier)	349,124
13	Komuna Qendër (Bilisht)	1,206,000
14	Komuna Cukalat	90,750
15	Komuna Shalë (Elbasan)	1,073,761
16	Komuna Hudenisht (Pogradec)	112,000
	Shuma	47,676,148

VENDIM
Nr.525, datë 20.7.2011

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN E STATUSIT TË ZHVILLUESIT TË ZONËS EKONOMIKE NË RRASHBULL, DURRËS, DHE MIRATIMIN E BONUSIT PËR SHOQËRINË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9789, datë 19.7.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike” dhe të neneve 4, pika 1, shkronja “g”, 5, pikat 1 e 3 dhe 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënie e statusit të zhvilluesit të zonës ekonomike në Rrashbull, Durrës, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
2. Miratimin e bonusit prej 6 (gjashtë) pikësh, për rezultatin ekonomik, financiar, teknik dhe mjedisor, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “GRUPPOMAI.O. AL” sh.p.k., Tiranë.
3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.526, datë 20.7.2011

PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSA E KONVIKTE, BURSAT E SHTETIT DHE PAGESAT E NXËNËSVE E TË STUDENTËVE, NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE, PËR VITIN SHKOLLOR 2011-2012

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 1 e 5 të ligjit nr.10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, të nenit 29 të ligjit nr.8872, datë 29.3.2002 “Për arsimim dhe formim profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 57 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Nxënësit që ndjekin studimet në institucionet arsimore publike dhe studentët që ndjekin një program studimi të ciklit të parë, me kohë të plotë, në institucionet arsimore publike, mund të përfitojnë bursë dhe përfitime të tjera, të parashikuara në këtë vendim, nga buxheti vjetor i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.
2. Përfitojnë bursë nxënësit dhe studentët, brenda kuotave e kriterëve të përcaktuara për sa vijon me këtë vendim:
 - 2.1. Sipas kriterit ekonomik (nxënës/student):

a) Nxënësit/studentët që vazhdojnë studimet larg vendbanimit të tyre në largësinë mbi 5 km dhe plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) Nxënësit që banojnë në fshat, të cilët nuk kanë shkollë 9-vjeçare brenda rrezes prej 5 km e që vendosen në konvikt publik;

c) Nxënësit/studentët që kanë përfituar statusin e jetimit dhe që plotësojnë kriterin ekonomik;

ç) Nxënësit/studentët të cilët kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykate të formës së prerë dhe që plotësojnë kriterin ekonomik;

d) Secili nga studentët bashkëshort me fëmijë, që plotëson kriterin ekonomik dhe që vendoset në konvikt publik;

dh) Fëmijët, nxënës apo student, që kanë statusin e invalidit, paraplegjikut dhe tetraplegjikut dhe që plotësojnë kriterin ekonomik.

2.2 Sipas rezultateve të arritura (nxënës/studentë):

a) nxënësit e arsimit të mesëm profesional që kanë mbaruar vitin shkollor pararendës me të gjitha notat 10 (dhjeta);

b) nxënësit të cilët vazhdojnë studimet në shkollat profesionale, në degët bujqësore, veterinare, pyjore dhe ndërtim, në vitet e dyta e lart dhe që kanë mbaruar vitin akademik pararendës me notën mesatare mbi 8 (tetë);

c) studentët që regjistrohen në vitin e parë të shkollës së lartë, që kanë mbaruar shkollën e mesme me medalje ari;

ç) studentët që regjistrohen në vitin e parë të shkollës së lartë, që janë shpallur nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës më të mirët e Maturës Shtetërore, sipas renditjes në listën e vlerësimit. Për vitin akademik 2011-2012, numri i tyre do të jetë 25 (njëzet e pesë) studentë. Kjo kategori studentësh përfiton bursë kur ata vazhdojnë studimet në institucionet e arsimit të lartë publik dhe vetëm për vitin akademik 2011-2012;

d) studentët që kanë mbaruar vitin akademik pararendës me të gjitha notat 10 (dhjeta);

dh) studentët që vazhdojnë studimet në programin e studimit “Matematikë” dhe në programin e studimit “Fizikë”, në vitin e dytë e lart, dhe kanë mbaruar vitin akademik pararendës me notën mesatare mbi 8 (tetë).

2.3 Jashtë kriterit ekonomik (nxënës/studentë):

a) nxënësit apo studentët, fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye apo për shkak të detyrës. Në fillim të çdo viti akademik Ministria e Brendshme, Shërbimi Informativ Shtetëror, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Mbrojtjes dërgojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës listën për këtë kategori nxënësish/studentësh;

b) nxënësit që vijnë nga zonat verilindore dhe juglindore të vendit (Tropoja, Hasi, Puka, Kukësi, Dibra, Bulqiza, Mati, Mirdita, Malësia e Madhe, Librazhdi, Gramshi, Kolonja, Përmeti, Pogradeci, Skrapari, Tepelena dhe rrethi Tiranë), të cilët regjistrohen dhe ndjekin studimet në vitin e parë shkollor 2011-2012, në shkollat e mesme profesionale.

2.4 Sipas degëve prioritare për zhvillimin e ekonomisë (nxënës):

Nxënësit që regjistrohen dhe ndjekin studimet në vitin e parë shkollor 2011-2012, në shkollat profesionale, në degët bujqësore, veterinare, pyjore, ndërtim dhe teknologji informacioni.

3. Nxënësit dhe studentët e të gjitha kategorive të mësipërme nuk përfitojnë bursë ose humbasin të drejtën e përfitimit të bursës, kur:

a) janë ndarë nga trangu familjar;

b) familjet e tyre ushtrojnë veprimtari private;

c) vazhdojnë studimet në një program të dytë studimi;

ç) shpallen ngelës dhe humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jokaluese.

4. Ministria e Arsimit dhe Shkencës harton planin e shpërndarjes së bursave, për drejtoritë arsimore rajonale (DAR-të) dhe zyrat arsimore (ZA-të), për vitet e para, sipas kuotave të miratuara (për nxënës/student). DAR/za-të, pas këshillimit me njësitë e pushtetit vendor, hartojnë planin e shpërndarjes së bursave dhe e dërgojnë në njësitë e pushtetit vendor (bashki/komunë), në përshtatje me kërkesat e paraqitura paraprakisht prej tyre për kategoritë e përcaktuara sipas pikës 2.1 të këtij vendimi.

5. Bashkitë dhe komunat, bazuar në planin e përcaktuar për to nga DAR/ZA-të, vendosin, me këshillat e tyre, për dhënien e bursave, sipas kritereve të përcaktuara në pikat 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të

këtij vendimi, duke u dhënë përparësi nxënësve dhe studentëve nga shtresat sociale në nevojë, për trajtimin me bursë të plotë ose, në pamundësi, trajtimin me gjysmëbursë.

5.1 Bashkitë dhe komunat, detyrimisht, duhet t'u dërgojnë në rrugë zyrtare drejtorive arsimore rajonale apo zyrave arsimore përkatëse vendimet për dhënien e bursave, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës.

5.2 Drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore duhet të dërgojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë dhe bashkive/komunave, që menaxhojnë konviktet, listën emërore të studentëve dhe të nxënësve bursistë, së bashku me vendimet origjinale të këshillave të bashkive dhe të këshillave të komunave. Një kopje e listës emërore të studentëve dhe nxënësve të trajtuar me bursë dërgohet edhe në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

5.3 Plani i bursave për nxënësit që regjistrohen dhe vazhdojnë studimet në vitin e parë shkollor 2011-2012, në shkollat profesionale, në degët bujqësore, veterinarë, pyjore, ndërtim dhe teknologji informacioni jepet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH), për bashkinë dhe komunën përkatëse, sipas vendndodhjes territoriale dhe administrative të konvikteve ku janë vendosur nxënësit, sipas numrit të nxënësve të regjistruar në këto degë. Drejtoria arsimore rajonale dhe zyra arsimore menjëherë, me mbarimin e regjistrimit në këto degë, dërgojnë informacion në MASH për numrin e nxënësve të regjistruar në këto degë.

6. Bursat e nxënësve për vitin e dytë e lart, rishqyrtohen dhe miratohen çdo vit nga këshilli i bashkisë dhe i komunës, sipas vendndodhjes territoriale dhe administrative të konvikteve ku janë vendosur nxënësit konviktorë. Drejtoritë arsimore rajonale paraqesin/dërgojnë zyrtarisht, në njësitë vendore kërkesat për miratim burse për nxënësit që përfitojnë bursë sipas shkronjave "a", "b" e "c" të pikës 2.2 të këtij vendimi.

6.1 Nxënësit që vitin e parë kanë përfutuar bursë, me vendim të këshillit të bashkisë apo komunës ku ata kanë vendbanimin e përhershëm, e marrin këtë bursë deri në përfundim të viteve të shkollimit, nëse atyre nuk u ndryshojnë kriteret ekonomike dhe nuk rezultojnë mbetës.

7. Bursat e studentëve për vitin e dytë e lart, rishqyrtohen dhe miratohen çdo vit nga institucionet publike të arsimit të lartë. Studentët e vitit të dytë e lart, që nuk kanë përfutuar bursë dhe plotësojnë kriterin ekonomik, mund të përfitojnë bursë brenda numrit të planit të bursave, të përcaktuara sipas këtij vendimi.

7.1 Numri i bursave për këtë kategori studentësh dhe për studentët që përfitojnë bursë, sipas pikës 2.2, është deri në 150 (njëqind e pesëdhjetë) në shkallë vendi, brenda numrit të përgjithshëm të bursave të dhëna për vitin akademik 2011-2012. Institucionet publike të arsimit të lartë paraqesin në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës kërkesat për studentët që përfitojnë bursë, sipas shkronjave "ç", "d" e "dh" të pikës 2.2 të këtij vendimi.

7.2 Ministria e Arsimit dhe Shkencës harton planin e shpërndarjes dhe e dërgon për ekzekutim në institucionet publike të arsimit të lartë. Studentët që vitin e parë kanë përfutuar bursë, me vendim të këshillit të bashkisë apo komunës ku kanë vendbanimin e përhershëm, e marrin këtë bursë deri në përfundim të viteve të shkollimit, nëse atyre nuk u ndryshojnë kriteret ekonomike dhe nuk rezultojnë mbetës.

7.3 Nxënësit e klasës së 12-të të shkollës së mesme "Nazmi Rushiti", Dibër, dhe nxënësit e klasës së 12-të të shkollës së mesme "Havzi Nela", Kukës, të cilët transferojnë programet e nivelit të dytë në shkollat e mesme profesionale Shkodër, pra nga njësitë vendore bashkia Peshkopi dhe bashkia Kukës në njësinë vendore bashkia Shkodër, njëkohësisht transferojnë zyrtarisht në bashkinë Shkodër numrin e bursave (listën e nxënësve, që kanë përfutuar bursë) për vitin shkollor 2010-2011.

7.4 Për nxënësit e tjerë, që plotësojnë kriteret ekonomike dhe kriterin e largësisë nga vendbanimi, sipas pikës 2.1 "Sipas kriterit ekonomik", kërkesat e tyre shqyrtohen dhe ata trajtohen me bursë nga njësitë e qeverisjes vendore.

8. Nga plani i bursave të miratuara për vitin akademik 2011-2012, Bashkisë së Tiranës i jepen 15 (pesëmbëdhjetë) bursa për studentët që vijnë nga familjet/shtresat sociale në nevojë dhe janë invalidë, paraplegjikë e tetraplegjikë, pavarësisht nga kriteri i studimit larg vendbanimit, ndërsa bashkive të tjera, të cilat në vendndodhjen e tyre territoriale, kanë institucione të arsimit të lartë publik, u jepen deri në 5 (pesë) bursa për këtë kategori studentësh.

9. Nxënësit dhe studentët që kanë përfutuar statusin e jetimit, nxënësit e Institutit të Fëmijëve që nuk Dëgjojnë dhe të Institutit të Fëmijëve që nuk Shikojnë përfitojnë falas veshmbathje, libra dhe fletore, sipas pasqyrës nr.6, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Nxënësit e Institutit të Fëmijëve që nuk Dëgjojnë

dhe të Institutit të Fëmijëve që nuk Shikojnë përjashtohen nga detyrimet e tarifave të shërbimeve të ndryshme, që ofrojnë shkollat.

9.1 Nxënësve dhe studentëve që kanë përfituar statusin e jetimit u sigurohen falas, nga fondet e shkollave përkatëse, shërbimi shëndetësor, shërbimi dentar dhe medikamentet, pas paraqitjes së librezës dhe të kartës shëndetësore, si dhe të epikrizës, nga qendra spitalore e rrethit.

9.2 Nxënësit jetimë që vazhdojnë shkollat e mesme a të larta për periudhën e pushimeve verore trajtohen me pagesë suplementare, që përcaktohet nga Këshilli i Ministrave, si dhe vetëm një vit kur humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jokaluese, nga njësitë e qeverisjes vendore, sipas vendndodhjes territoriale.

9.3 Fëmijët dhe mësuesit e institucioneve të arsimit special, pa konvikt, trajtohen falas nga shteti me një vakt ushqim (drekë), me vlerë deri në 150 (njëqind e pesëdhjetë) lekë në ditë.

10. Fondet buxhetore për mbulimin e shpenzimeve për bursat, si dhe numri i bursave për studentët administrohen nga institucionet publike të arsimit të lartë. Bursat paguhen çdo muaj me kalim në numrin e llogarisë bankare të çdo studenti.

10.1 Fondet buxhetore për mbulimin e shpenzimeve për bursat, si dhe numri i bursave për nxënësit administrohen nga bashkia e komuna, sipas vendndodhjes territoriale dhe administrative të konvikteve ku janë vendosur nxënësit konviktorë. Masa mujore e bursës u jepet nxënësve në formën e kuotës ushqimore, në konvikt.

10.2 Nxënësve të cilët nuk janë vendosur/akomoduar në konvikt, për mungesë kapacitetesh, bursa u paguhet çdo muaj nga bashkia/komuna, në llogarinë bankare të nxënësit/prindit përfitues, pranë bankave të nivelit të dytë apo në zyrat e Postës Shqiptare. Drejtorët e shkollave profesionale e social-kulturore dërgojnë, çdo muaj, pranë njësive të qeverisjes vendore, informacion për frekuentimin e shkollës për nxënësit që përfitojnë bursë.

11. Niveli i bursës për nxënësit dhe studentët, jepet sipas pasqyrave nr.2 e nr.3 dhe kuota financiare ushqimore ditore jepet sipas pasqyrave nr.4 e nr.5, që i bashkëlidhen këtij vendimi. Drejtuesit e fakulteteve dërgojnë zyrtarisht, çdo muaj, pranë njësive/departamentit të financës, frekuentimin e shkollës për studentët që përfitojnë bursë.

12. Ministria e Arsimit dhe Shkencës për vitin e ri akademik 2011-2012, të japë 1650 (një mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) bursa për nxënësit dhe 1900 (një mijë e nëntëqind) bursa për studentët, për hyrjet e reja në vitin e parë në sistemin arsimor publik, për të gjitha kategoritë e parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi.

13. Efektet financiare për vitin akademik 2011-2012 të përballohen nga fondet e Buxhetit të Shtetit, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për vitin 2011, për pjesën e vitit 2011, si dhe nga fondet e Buxhetit të Shtetit që do të miratohet, për vitin 2012, për pjesën e vitit 2012.

14. Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave, për vitet e para, është data 15 dhjetor 2011, për të gjitha kategoritë e shkollave, ndërsa për vitin e dytë e lart është data 15 nëntor 2011.

15. Ministri i Arsimit dhe Shkencës për raste të veçanta, kur vendimet e këshillave të njësive të qeverisjes vendore dërgohen jashtë afatit të përcaktuar në këtë vendim, ka të drejtë të shqyrtojë dhe të rivendosë në afat përfitimin e bursës për nxënësin/studentin.

16. Vendimet e njësive të qeverisjes vendore dhe ato të institucioneve publike të arsimit të lartë publikohen për komunitetin, median dhe institucionet e tjera vendore apo qendrore.

17. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, DAR/ZA-të, institucionet publike të arsimit të lartë dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Pasqyra nr.1

**KUSHTET EKONOMIKE TË NXËNËSIT DHE STUDENTIT PËR DHËNIEN E BURSËS
(VITI MËSIMOR 2011-2012)**

Nr.	Përbërja familjare	Përfitojnë bursa	Përfitojnë gjysmëbursa	Me pagesë
	Për qytetin	Me të ardhura mujore lekë/frymë	Me të ardhura mujore lekë/frymë	Me të ardhura mujore lekë/frymë
1	Për familjet me 2 persona	deri 3,200	3,200-4,600	mbi 4,600
2	Për familjet me 3 persona	deri 3,100	3,100-4,500	mbi 4,500
3	Për familjet me 4 persona	deri 3,000	3,000-4,400	mbi 4,400
4	Për familjet me 5 persona	deri 2,900	2,900-4,300	mbi 4,300
5	Për familjet me 6 persona	deri 2,800	2,800-4,200	mbi 4,200
6	Për familjet me 7 persona	deri 2,700	2,700-4,100	mbi 4,100
7	Për familjet me 8 persona	deri 2,600	2,600-4000	mbi 4000

Shënim. Nxënësit dhe studentët nga fshati përfitojnë bursë, kur familja përfiton ndihmë ekonomike, në varësi të masës së kësaj ndihme, brenda planit të akorduar për secilën njësi të pushtetit vendor.

Pasqyra nr.2

NIVELI I BURSËS PËR NXËNËSIT (VITI MËSIMOR 2011-2012) NË LEKË

Nr.	Kategoritë e bursave sipas shkollave	Kuotat e bursës			Financimi nga nxënësi	Financimi nga shteti
		Për kuotë ushqimi	Shpenzime vetjake	Totali i kuotës		
1	Për shkollat 9-vjeçare dhe të mesme					
	a) Bursa	6,165	200	6,365	0	6,365
	b) Gjysmëbursa	6,165	200	6,365	3,182	3,183
	c) Me pagesë	6,165	200	6,365	6,365	0
2	Shkolla e Mjeshtërisë Sportive dhe Arsimit Special					
	a) Bursa	6,683	200	6,883	0	6,883
	b) Gjysmëbursa	6,683	200	6,883	3,441	3,442
	c) Me pagesë	6,683	200	6,883	6,663	0
3	Nxënësit jetimë	6,683	200	6,883	0	6,883

Pasqyra nr.3

NIVELI I BURSËS PËR STUDENTËT (VITI MËSIMOR 2011-2012) NË LEKË

Nr.	Kategoritë e bursave sipas shkollave	Kuotat e bursës			Financimi nga nxënësi	Financimi nga shteti
		Për kuotë ushqimi	Shpenzime vetjake	Totali i kuotës		
1	Universitetet, Akademia e Arteve dhe shkollat e tjera të larta					
	a) Bursa	6,900	2,000	8,900	0	8,900
	b) Gjysmëbursa	6,900	2,000	8,900	4,450	4,450
	c) Me pagesë	6,900	2,000	8,900	8,900	0
2	Akademia e Edukimit Fizik dhe Sporteve					
	a) Bursa	7,410	2,000	9,410	0	9,410
	b) Gjysmëbursa	7,410	2,000	9,410	4,705	4,705
	c) Me pagesë	7,410	2,000	9,410	9,410	0

KUOTAT FINANCIARE SIPAS NORMAVE NË NATYRË PËR USHQIMIN E NXËNËSVE
(VITI MËSIMOR 2011-2012)

Nr.	Emërtimi	Njësia matëse	Norma ditore	Vlera energjetike (në kcal)	Çmimi mesatar	Vlera ditore
1	Bukë	Gramë	350-400	977	100	35
2	Makarona	Gramë	30	107	120	3.6
3	Oriz	Gramë	30	109	150	4.5
4	Sheqer	Gramë	40	157	100	4
5	Fasule	Gramë	30	93	150	4.5
6	Perime	Gramë	130	27	100	13
7	Fruta	Gramë	100	42	100	10
8	Vaj	Gramë	30	270	234	7
9	Gjalpë	Gramë	20	152	531	11
10	Mish	Gramë	90	130	650	58
11	Djathë	Gramë	25	40	300	7
12	Reçel	Gramë	20	93	250	5
13	Vezë	Kokërr	1	42	8	8
14	Qumësht	Gramë	200	98	80	16
15	Patate	Gramë	200	170	40	8
16	Nënprodukte mishi	Gramë	30	100	400	12
	Kuota ditore			2746		206

Shënim. Çmimi mesatar është indeksuar me normën mesatare të inflacionit, viti 2010. Është e domosdoshme që nxënësi të marrë kuotën ditore në lekë dhe në kalori, ndërsa gramaturat dhe lloji i ushqimit mund të ndryshojë sipas menyre të ndryshme, sipas çmimeve që ofrohen nga konkurrenca e prokurimeve dhe ndikimit të faktorëve të tjerë (gramaturat e normës ditore në pasqyrë janë përdorur për efekt planifikimi).

KUOTAT FINANCIARE SIPAS NORMAVE NË NATYRË PËR USHQIMIN E
STUDENTËVE (VITI MËSIMOR 2011-2012)

Nr.	Emërtimi	Njësia matëse	Norma ditore	Vlera energjetike (në kcal)	Çmimi mesatar në lekë/kg	Vlera ditore
1	Bukë	Gramë	400	1,117	100	40
2	Makarona	Gramë	30	107	120	3.6
3	Oriz	Gramë	40	145	150	4.5
4	Sheqer	Gramë	40	157	100	4
5	Fasule	Gramë	40	124	150	4.5
6	Perime	Gramë	130	27	100	13
7	Fruta	Gramë	100	42	100	10
8	Vaj	Gramë	40	360	234	7
9	Gjalpë	Gramë	20	152	531	11
10	Mish	Gramë	98	140	750	67.5
11	Djathë	Gramë	42	66	400	10
12	Reçel	Gramë	44	190	350	7
13	Patate	Gramë	200	170	12	12
14	Qumësht	Gramë	200	98	80	16
15	Vezë	Kokërr	1	42	8	8
16	Nënprodukte mishi	Gramë	30	100	400	12
	Kuota ditore			3,037		230

KUOTAT FINANCIARE TË VESHMBATHJES (VITI MËSIMOR 2011-2012)

Nr.	Emërtimi	Kuota financiare në lekë e veshmbathjes për një vit kalendarik
1	Për fëmijët e arsimit special	7,000 (shtatë mijë) lekë
2	Për jetimët	10,000 (dhjetë mijë) lekë

VENDIM
Nr.532, datë 13.7.2011

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT “PËR MENAXHIMIN, OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE PËRMIRËSIMIN TEKNIK TË TERMINALIT TË KONTEINERËVE NË PORTIN E DURRËSIT”, TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT DHE BASHKIMIT TË PËRKOZHËM TË SHOQËRIVE “DURRËS KURUM SHIPPING” SHA DHE “GLOBAL PORTS HOLDING” SHA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 4 e 27 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit të lidhur ndërmjet Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, si autoritet kontraktues dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Durrës Kurum Shipping” sh.a., dhe “Global Ports Holding” sh.a., për menaxhimin, operimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin teknik të terminalit të konteinerëve në Portin e Durrësit, sipas tekstit dhe anekseve që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendimi hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.563, datë 3.8.2011

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.138, DATË 23.3.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRITERET TEKNIKE TË VLERËSIMIT DHE PËRLLOGARITJES SË MASËS SË SHPËRBLIMIT TË PASURIVE QË SHPRONËSOHEN, TË PASURIVE QË ZHVLERËSOHEN DHE TË TË DREJTAVE TË PERSONAVE TË TRETË, PËR INTERES PUBLIK”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit të 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas pikës 7 shtohet pika 7/1, me këtë përmbajtje:

“7/1. Përjashtimisht, për investimet në akse rrugore kombëtare, shpronësohen edhe zotëruesit privatë të objekteve/pasurive të paluajtshme të paregjistruara në regjistrat publikë të Zyrës së Regjistrimit

të Pasurive të Paluajtshme. Enti që bën shpronësimin, ka të drejtë të kryejë procedurat e shpronësimit ndaj zotëruesve të këtyre pasurive, pas plotësimit të kushteve të mëposhtme:

a) Zotëruesit e objektit janë në proces administrativ pranë ALUIZNI-t sipas ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje, të ndryshuar;

b) Ndërtimi pa leje ose shtesa pa leje, që zotëron subjekti që shpronësohet, gëzon statutet i vetëdeklaruar e i kualifikuar më parë për leje legalizimi nga ALUIZNI, sipas të gjitha kriterëve të vendimit nr.438, datë 28.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo”, të ndryshuar;

c) Zotëruesit e objektit janë në proces për t’u pajisur me leje legalizimi pasi:

i) disponohet një akt i Këshillit të Ministrave, i botuar në Fletoren Zyrtare, në zbatim të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006, të ndryshuar, që identifikon objektin e tyre dhe këtë subjekt (person fizik/juridik) si zotërues të objektit pa leje apo shtesës pa leje në parcelën ndërtimore; apo

ii) subjekti zotërues ka ngritur objektin në tokë të tij/shtetit dhe nuk është skualifikuar nga procedura e legalizimit.

Procedurat e mësipërme të shpronësimit quhen të kryera nga çasti kur zotëruesi i objektit pa leje apo shtesës pa leje i nënshkruan entit që kryen shpronësimin deklaratën sipas aneksit 1, dhe hyn në fuqi vendimi i Këshillit të Ministrave.

Të gjitha detyrimet ndaj personave të tjerë dhe të tretëve, në lidhje me të drejtat e pronës, zgjidhen nga zotëruesi.

Përjashtimisht, në zbatim të detyrimeve sipas këtij akti, ALUIZNI qendror, për të gjitha dosjet e subjekteve vetëdeklaruese, të kualifikuar, sipas paragrafit 1, arkivon me shënim të veçantë dosjen dhe pezullon çdo veprim administrativ të mëtejshëm me marrjen e urdhërimit për pezullim nga ministria e linjës. Këto dosje të ALUIZNI-t arkivohen si praktika të veçanta pas dërgimit nga MPPT-ja të listës së pasurive dhe numrit rendor të subjektit në vendimet respektive të Këshillit të Ministrave dhe janë subjekt depozitimi në Arkivin e Shtetit.”.

2. Përmbajtja e pikës 1 të këtij vendimi zbatohet edhe për kërkesat për shpronësim, të cilat janë publikuar para hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Për këto raste, struktura përgjegjëse që merret me procedurën e shpronësimit autorizohet të përfundojë procedurën, për këtë kategori objektesh, brenda 30 (tridhjetë) ditëve.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e tij deri në datën 31.6.2012.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Aneksi A

Unë _____, i pajisur më kartë identiteti nr. _____, me përgjegjësi të plotë ligjore, deklaroj se çdo rrethanë e paraqitur në këtë deklaram për objektin me karakteristikat e mëposhtme: shtëpi banimi/objekt social _____, kate _____, mbi nivelin e kuotës zero _____ me sipërfaqe kati _____, gjithsej _____, deklaruar më datë _____, për pajisje me leje legalizimi sipas ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, është i vërtetë dhe se mbaj përgjegjësi civile dhe ligjore për çdo dëm që mund t’i krijohet shtetit në rast deklarami të rremë për efekt të kryerjes së këtij shpronësimi sipas pikës 7/1 të vendimit nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar.

Deklaruesi:

(emër, mbiemër, firmë)

VENDIM
Nr.583, datë 10.8.2011

**PËR KALIMIN E PASURISË SË PALUAJTSHME KANTIERI DETAR DURRËS DHE
AKUATORIUM NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË AUTORITETIT PORTUAL DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 3, e 13, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të nenit 19 të ligjit nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë” dhe të ligjit nr.9130, datë 8.9.2004 “Për autoritetin portual”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Autoritetit Portual Durrës të pasurisë së paluajtshme publike, shtetërore, me emërtimin ish-Kantieri Detar Durrës, ndërtime të ngritura mbi të, dhe Akutorium, me sipërfaqe dhe planimetri sipas aneksit 1, bashkëlidhur, pa të drejtë vendosjeje barre siguroese, në kuptim të Kodit Civil, dhe përjashtuar nga procedurat e shpronësimit në favor të të tretëve.

2. Pasuria e paluajtshme me emërtimin ish-Kantieri Detar Durrës dhe Akutorium, t’i nënshtrohet përmirësimeve në dobi të zhvillimit të masterplanit të miratuar me vendimin nr.546, datë 28.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e masterplanit për zhvillimin e Portit të Durrësit”, dhe zgjidhjeve efektive që rrisin rentabilitetin e portit.

3. Ngarkohen Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Autoriteti Portual Durrës dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 24.8.2011
Doli nga shtypi më 25.8.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 36 lekë